



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 28.03.2022

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË
VOGLA DHE TË MESME”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “*Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme*”, në mbledhjen e datës 28.03.2022, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Eduard Ndreca.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm:

- Znj. Vasilika VJERO - Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Znj. Elira DEMIRAJ - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit;
- Znj. Arjana DYRMISHI - Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik;
- Evis FICO - Këshilltare, kabineti Ministrit të financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, ka si qëllim të përcaktojë kuadrin rregullator ligjor dhe institucional, i cili do të mundësojë kategorizimin e këtyre subjekteve në bazë të qarkullimit vjetor dhe numrit të të punësuarve si dhe të sigurojë format për mbështetje dhe asistencë nga shteti për të nxitur rritjen e kapaciteteve/potencialit të operimit të bizneseve në tregun shqiptar dhe forcimin e konkureshmërisë së tyre, duke ndikuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Në kushtet kur në tregun shqiptar bizneset janë ndeshur me mungesë informacioni e shërbimesh mbështetëse nga institucionet publike si dhe me vakum ligjor për të rregulluar e mundësuar format e mbështetjes dhe ndërveprimit të ndërmarrjeve apo aktorëve të tjerë me këto institucione me qëllim përfitimin dhe lëvrimin e fondeve të posaçme nga këto të fundit, për kategorinë e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, diktohet sot nevoja e rishikimit të kuadrit ligjor dhe krimit të faciliteteve për mbështetjen e këtyre subjekteve, për të qenë koherent me nevojat e tyre.

Nëpërmjet hartimit të këtij projektligji synohet që të arrihen objektivat e mëposhtme:

- Rritja e mbështetjes për NMVM-të në nivel 50%;
- Rritja e aplikimeve për teknologji të reja nga zero aktualisht në 50% brenda vitit 2022;
- Rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja NMVM dhe rritja e numrit të të punësuarve,
- Futja e instrumenteve të reja financiare me 10%, respektivisht për çdo tregues;
- Rritja e shkallës së përthithjes së granteve në masën 100% nga bizneset.

Me anë të këtij projektligji për NMVM-të synohet të ofrohet mbështetje shtetërore, e cila do të ofrohet nëpërmjet formave, si në vijim:

- Krijimi i një fondi nga buxheti i shtetit;
- Mbështetje financiare nga partnerët për zhvillim vendas ose të huaj;
- Garanci shtetërore të huas sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të qeverisë, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe kufizimet e borxhit shtetëror e të garancive shtetërore të huave;

- Shërbime mbështetëse publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

2.2. Përmbajtja e projektligjit

Projektligji është hartuar në 4 (katër) krerë dhe përmban 20 (njëzet) nene në total, të cilat kanë këtë përmbajtje:

- Në kreun I, “Dispozita të përgjithshme”, nga Neni 1 deri në Nenin 8, përcaktohen objekti i projektligjit, qëllimi, përkufizimet, kategoritë e NMVM-ve në ndërmarrje të vogël, mikrondërmarrje dhe ndërmarrje e mesme, deklaratat për kategorinë e NMVM-ve, burimet e të dhënave për llogaritjen e personelit, vlerës së qarkullimit dhe periudhës së raportimit për NMVM-të, personeli për periudhën e raportimit të NMVM-ve dhe llogaritja e të dhënave për NMVM-të.
- Në kreun II “Mbështetja shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, nga Neni 9 deri në Nenin 16, parashikohen dispozitat rregulluese në lidhje me dhënien e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, mbështetjen financiare buxhetore, garancitë shtetërore të huas, shërbimet publike për ndërmarrjet, raportet vjetore, strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve si dhe burimet e financimit të NMVM-ve.
- Kreu III “Këshilli konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, përmban Nenin 17, në të cilin parashikohen dispozita në lidhje me Këshillin konsultativ për ndërmarrjet.
- Kreu IV “Dispozita përfundimtare”, Neni 18 deri në Nenin 20, përmban dispozitat në lidhje me nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij projektligji, shfuqizimin e ligjit ekzistues dhe hyrjen në fuqi të tij.

2.3 Risitë e projektligjit

Miratimi i këtij projektligji mundëson krijimin e një kuadri ligjor dhe institucional më të plotë e të përmirësuar, koherent me kërkesat dhe nevojat aktuale të tregut dhe të bizneseve/ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Masat mbështetëse për NMVM-të që ofrohen do të përcaktohen me ligj për të gjitha ndërmarrjet pavarësisht sektorëve ku operojnë. Në veçanti, nëpërmjet përgatitjes së referencave të reja ligjore dhe nxjerrjes së akteve nënligjore nga organet kompetente për mbështetjen e biznesit, do të lehtësohen hartimi dhe implementimi i politikave mbështetëse për ndërmarrjet dhe ekosistemin e bizneseve në vend si dhe përafrimi i termave dhe përkufizimeve me *acquis communautaire*.

Ky projektligj mbështet krijimin e ndërmarrjeve të reja, zhvillimin e tyre si dhe mundëson forma të reja të dhënies së mbështetjes financiare dhe jo financiare. Në këtë mënyrë, ndërmarrjeve u ofrohet ndihmë direkte dhe falas në mënyrë të vazhdueshme, të cilat nëse përthithen në mënyrën e duhur nga bizneset, do të arrijnë të kenë një rritje të shpejtë dhe të

sjellin një impakt domethënës në rritjen e ekonomisë dhe punësimin si dhe risi inovative të ndjeshme në mjedisin ekzistues të ndërmarrjeve në vend.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË KUSHTETUESE DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI DHE AKTET NDËRKOMBËTARE

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji i propozuar është hartuar pjesërisht në përputhje me rekomandimin e Komisionit, të 6 majit 2003, në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (Njoftimi zyrtar L 124 , 20/05/2003 P. 0036 – 0041). CELEX 32003H0361.

V. KONSULTIMI PUBLIK

Projektligji është konsultuar nga nismëtari nëpërmjet takimeve me grupe akademike nga universitete të ndryshme, dhoma tregtare dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore, nëpunëset/nëpunësit e nxitjes së biznesit në MFE dhe organizatat kombëtare të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare si World Bank, EBRD, UN.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nuk ka zhvilluar seancë konsultimi publik.

VI. EFEKTET FINANCIARE

Kostot e drejtpërdrejta për buxhetin e shtetit do të jenë shumat e alokuara për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nëpërmjet AIDA-s, në formën e mbështetjes financiare (grante) dhe shërbime mbështetëse (si trajnim, këshillim etj).

- Në vitin 2022 janë parashikuar kosto, gjithsej, 51 500 000 lekë, e cila përfshin grante 50 000 000 lekë, krijimin dhe funksionimin e sektorit të trajnimit 1 500 000 lekë.

- Në vitin 2023 janë parashikuar kosto, gjithsej, 53 000 000 lekë, e cila përfshin grante 50 000 000 lekë, funksionimin e sektorit të trajnimit në shumën 3 000 000 lekë.
- Në vitin 2024 janë parashikuar kosto, gjithsej, 53 000 000 lekë, e cila përfshin grante 50 000 000 lekë, funksionimin e sektorit të trajnimit në shumën 3 000 000 lekë.

VII. DISKUTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

- Për të prezantuar projektligjin në Komision ishte e pranishme Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Gjatë prezantimit, Znj. Vjero referoi përpara komisionit çështjet kryesore, risitë dhe efektet e pritshme që synohen të arrihen nëpërmjet zbatimit të këtij projektligji, i cili ka në fokus krijimin e një kuadri ligjor nëpërmjet të cilit do të përkufizohen e kategorizohen ndërmarrjet si dhe përcaktimi i politikave shtetërore dhe kuadrit institucional rregullator në ndihmë të këtyre ndërmarrjeve.

Zëvendësministrja shpjegoi se ky ligj ka si objekt marrjen e masave dhe aplikimin e politikave shtetërore për të nxitur krijimin e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme me synimin e rritjes së konkurrencës ndërmjet tyre dhe mbështetjes së bizneseve në kuadër të rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë në vend.

Gjithashtu, Zëvendësministrja Vjero referoi se deri më sot, ka pasur një interes të ulët në skemat e bashkëfinancimit të AIDA-s, për shkak të mungesës së informacionit nga bizneset, mënyrës së aplikimit, mungesës së shërbimeve mbështetëse për biznesin etj. Për këtë është vlerësuar shumë i nevojshëm rishikimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e ndërmarrjeve për të qenë koherent me nevojat e tregut. Asnjë mbështetje financiare direkte nuk ekziston në formën e granteve për kërkime dhe zhvillim. Për më tepër mungojnë programet për të financuar drejtpërsëdrejti bashkëpunimin e ndërmarrjeve dhe akademisë edhe pse si ndërmarrjet si organizatat kërkimore kanë të drejtë të aplikojnë për thirrje për propozime pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion. Ekzistenca e mangësive ligjore për dhënien e fondeve nga AIDA për bizneset është një nga çështjet e cila është adresuar në këtë ligj.

Gjithashtu, Znj. Vjero sqaroi se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vlerësuar se zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues, konkretisht ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar, ka pasur mungesa të hapësirave ligjore për hartimin e skemave të garancisë shtetërore të huas për mbështetjen e kreditimit të ndërmarrjeve dhe, për më tepër, nuk mundëson rregullimin e plotë të bazës ligjore për ofrimin e shërbimeve publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Zëvendësministrja Vjero informoi se nëpërmjet këtij projektakti do të krijohet një Këshill konsultativ, i cili do të shërbejë si organ këshillimi dhe transparence i cili do të ngrihet pranë institucioneve përgjegjëse dhe do të ketë përfaqësues nga komuniteti i biznesit si dhe nga institucionet publike.

Gjithashtu ky projektligj do të sigurojë dhënien e mbështetjes shtetërore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse si dhënie informacioni, këshillimin, trajnimin; zhvillimin profesional apo ritrajnimin, dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet dhe personat fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje.

- Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komision u diskutua dhe u konfirmua se projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe respekton të gjitha përcaktimet ligjore.

Anëtarët e komisionit adresuan pyetje kundrejt përfaqësuesve të nismëtarit në lidhje me çështje të ndryshme të parashikuara në projektligj, kryesisht mbi efektet dhe mbështetjen që do të ofrojë zbatimi i këtij projektligji, për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në respektim edhe të rekomandimeve nga Komisioni ndërkombëtar dhe në kuadër të Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve, target grupet përfituese nga ky ligj, vet/deklarimi i subjekteve, pa kosto, pranë institucioneve përgjegjëse me qëllim aksesin në format e përfitimit/mbështetjes shtetërore me grante, shërbime falas, asistencë dhe informacion, impaktin që do të ketë ky projektligj etj..

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji dhe në përfundim të diskutimeve, nga kryetarja e komisionit znj. Klotilda Bushka, relatori Eduard Ndreca dhe shumica e anëtarëve të komisionit u theksua rëndësia e kësaj nisme, duke vlerësuar këtë projektligj si një hap konkret, edhe pse pak i vonuar, i cili mund të konsiderohet si një e mirë publike, e cila do të mundësojë rregullimin dhe qartësimin e kuadrit ligjor si dhe sigurojë mekanizmat mbështetëse për përfitimin dhe stimulimin e NMVM në tregun e biznesit, veçanërisht ato subjekte që kërkojnë të operojnë në treg duke përdorur teknologjinë, duke i shërbuar në këtë mënyrë rritjes së ekonomisë në vend dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe iu kërkuar të gjithë kolegëve ta miratojnë këtë projektligj, duke u ndalur në disa pika të teknikës legjislative, për t'ia sugjeruar komisionit përgjegjës.

VIII. REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

Në përputhje me rregullat e teknikës legjislative, të kryhen rregullimet e mëposhtme:

Neni 2 i projektligjit, në funksion të qartësisë në përmbajtje të riformulohet si më poshtë:

**“Neni 2
Qëllimi**

“Qëllimi i këtij ligji është krijimi një kuadri rregullator ligjor dhe institucional për përkufizimin dhe kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si dhe për përcaktimin e politikave shtetërore që zbatohen në mbështetje të tyre”.

Neni 3 i projektligjit “Përkufizimet”, për teknikë legjislativë, prapa çdo përkufizimi, sipas kuptimit, të shtohen fjalët “është”, “janë” dhe “do të thotë”

Gjithashtu, tek **Neni 3** i projektligjit, duke qenë se “Ndërmarrjet e lidhura” përfshihen në përmbajtjen e “Ndërmarrjes partnere”, pika 8 të jetë pika 9, dhe anasjelltas.

Në shkronjën a), pika 5, neni 4, i projektligjit, në harmonizim me legjislacionin e zbatueshëm, të zëvendësohet numri “0” me numrin ”1” (“1 deri në 9 persona”)

Në pikën 2, të nenit 17, të projektligjit, për të garantuar efektivitetin e Këshillit konsultativ për NMVM, sugjerohet të rishihet me nismëtarin numri i anëtarëve të Këshillit, nëse mund të jetë më i reduktuar.

Në nenin 17, të projektligjit dhe në tekstin e projektligjit në tërësi, për teknikë legjislativë, të përshtatet/unifikohet sipas fushave “ministri përgjegjës”.

Në pikën 1 të Nenit 18, të projektligjit për të garantuar zbatimin brenda afateve të dispozitave të këtij projektligji, të zëvendësohet afati prej/fjala “një viti” me afatin/togfjalëshin “3 muajve”

IX. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për t’ia përcjellë mendimin Komisionit përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

RELATOR

EDUARD NDRECA

KRYETAR

KLOTILDA BUSHKA